

## KONTRATË SHIT-BLERJE KUOTASH

Sot, më datë 12/10/2018, ora 14.00, në Tiranë, në selinë e shoqërisë "IN PRIMIS" shpk: Rr. "Murat Toptani", Gjergji Center, Kati 6, Tiranë u paraqitën Personalisht palët e mëposhtme, të cilët redaktuan këtë kontratë shit-blerje kuotash me termat e mëposhtme:

**Shitësi:** z. **Isuf Shehu**, i biri i Maksim-it, shtetas Shqiptar, lindur ne Berat, me date 21.06.1981, banues ne adresën Rr. "Medar Shtylla", Pall. "Aurora", Kati 2, Ap. 8, Tirane, mbajtes i leternjoftimit nr. 030977020, Madhor dhe me zotësi te plote për te vepruar.

Këtu e më poshtë *Shitësi*.

**Blerësit:** z. **Ilir Qafa**, i biri i Napolon-it, shtetas shqiptar, lindur në Berat, më 09.06.1978 dhe banues në adresën Rr. "Alla", Pall. Xheluks, Hyrja B, Kati 3, Ap.8, Tiranë, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit nr. 033276346., Madhor dhe me zotësi te plote për te vepruar.

Këtu e me poshtë *Blerësi*.

Palët e kësaj kontrate:

Në zbatim te nenit 73, 74 dhe 75 e vijues te ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, ligjit nr. 131/2015 "Për Qendrën Kombëtare te Biznesit", dhe statutit të shoqërisë "IN PRIMIS" sh.p.k, te detyrueshme për tregtaret.


bien dakord dhe shprehin vullnetin e tyre për te lidhur këtë kontratë me kushtet dhe termat e mëposhtme:

1. z. **Isuf SHEHU**, është ortak dhe zotërues i 50 % të kuotave të shoqërisë "IN PRIMIS" sh.p.k., (me NUIS L72414023E ) ose 1 kuotë me vlerë të përgjithshme prej 5.000 (pesëmijë) lekë, kurse Blerësi **Ilir Qafa** është ortak i shoqërisë zotërues i 50 % të kuotave të shoqërisë "IN PRIMIS" sh.p.k., (me NUIS L72414023E ) ose 1 kuotë me vlerë të përgjithshme prej 5.000 (pesëmijë) lekë.

2. z. **Isuf SHEHU**, me cilësinë e ortakut të shoqërisë i shet 50 % të kuotave nga totali i shoqërisë "IN PRIMIS" sh.p.k., blerësit z. **Ilir Qafa**, ose 1 (një) kuotë, me një çmim total prej 5.000 (pesë mijë) lekë.

3. Shitësi nuk ka detyrime të pashlyera ndaj shoqërisë "IN PRIMIS" sh.p.k.

4. Nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate nga palët, Shitësi humbet cilësinë e pronarit mbi 50% të kuotave ( 1 kuotë ) që ai i transferon tek blerësi.



5. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet që burojnë sipas legjislacionit në fuqi nga titulli i pronësisë mbi këto kuota, objekt i kësaj kontrate, që nga data e nënshkrimit të saj, i kalojnë Blerësit. Blerësi bëhet zotërues me të drejta të plota i këtyre 50% të kuotave ( 1 kuotë ) në shoqërinë "IN PRIMIS" sh.p.k.

6. Kjo kontratë hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj nga palët kontraktuese.


7. Palët zotohen se do të zgjidhin më mirëkuptim çdo mosmarrëveshje lidhur me këtë kontratë, në të kundërt, kompetente do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

8. Kontrata u hartua në tre kopje origjinale me fuqi të njëjtë juridike. Një kopje shkon për regjistrim në Qendrën Kombëtare të Biznesit, një kopje e merr blerësi dhe një kopje e merr shitësi.

#### PALET


SHITËSI

Isuf SHEHU



BLERËSI

Ilir QAFA



 **PRIMIS**  
Law, Tax and Strategic Planning  
EEO01871510  
NUI5: L7261023E